



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 170, datë 23.10.2020

**PËR
REVOKIMIN E LICENCËS PËR TË USHTRUAR VEPRIMTARINË SI VLERËSUES
DËMESH NË SIGURIME**

Në bazë dhe për zbatim të neneve 13, 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 228, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E :

Në bazë të nenit 226 e vijues, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Autoriteti licencën vlerësuesit e dëmeve në sigurime.

Z. Gentian Mustafa është licencuar nga Autoriteti për të ushtruar veprimtarinë e vlerësuesit të dëmeve materiale dhe shëndetësore sipas licencës nr. 129, datë 27.06.2016.

Në zbatim të nenit 229 të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe Rregullores nr. 85, datë 03.07.2017 “Mbi licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime”, vlerësuesi i dëmeve duhet të disponojë policën e sigurimit të përgjegjësisë profesionale.

Z. Gentian Mustafa nuk disponon policën e sigurimit të përgjegjësisë profesionale.

Në këto kushte, bazuar në nenin 9, pika 3, të Rregullores nr. 85, datë 03.07.2017 “Mbi licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime”, Autoriteti ka dërguar e-mail në datat 22.09.2020 dhe 07.10.2020 ku e njofton z. Mustafa se do fillojë procesin e revokimit të licencës së ushtrimit të veprimtarisë si vlerësues i dëmeve në sigurime, për mosdisponim të policës së sigurimit të përgjegjësisë profesionale.

Nga ana e z. Gentian Mustafa nuk ka patur asnjë reagim.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Bazuar në nenin 228, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, i revokohet licenca nr. 129, datë 27.06.2016, z. Gentian Mustafa, për të ushtruar veprimtarinë si vlerësues dëmsh në sigurime.**
- 2. Licenca nr. 129, datë 27.06.2016, duhet të depozitohet në Autoritet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit.**
- 3. Ngarkohen Departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR

Deniz DERALLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE